



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

P.nr.470/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të akuzuarit: N.M. nga ..., për shkak të veprës penale: Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës nga neni 250 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.515/2017 të datës 27.07.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.24.04.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Natasha Radovic, të pandehurit N.M., me datë25.04.2019 e shpalli publikisht, ndërsa me datë 26.04.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

N.M., nga i ati ... dhe e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datë ... në ..., ku edhe jeton në lagjen Rr. “...” pnr, i divorcuar, punon si punëtorë fizik, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal ..., Rom, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

SEPSE:

Me datën 29.06.2017 rreth orës 19:00, në ..., në sheshin “...” saktësisht në pastiqerinë “...” ka detyruare të dëmtuarin-të birin R.M. që në lëmosh të lyp para ose dobi të tjera materiale për të pandehurin, me ç`rast i dëmtuari në ditën kritike është takuar nga policia e Kosovës pa shoqërimin e askujt dhe në gjendje jo të mirë higjienike duke ju ekspozuar rreziqeve të ndryshme në rrugë, duke mos u përkujdesur për edukimin e të dëmtuarit-të birit të tij R.

Me këtë ka kryer veprën penale: Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës nga neni 250 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 75 të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në afat prej dy (1) viti, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
2. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 10€ ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
3. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.515/2017 të datës 27.07.2017, kundër të akuzuarit N.M. nga ..., për shkak të veprës penale: Keqtrajtim apo braktisja e fëmijës nga neni 250 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se e ndjej veten fajtor për veprën penale që i vihet në barrë si dhe ka shprehur keqardhje për atë që ka ndodhur, mirëpo jetoj në kushte të vështira ekonomike.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se i pandehuri e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, ky pranim është në pajtim edhe me provat materiale, gjendjen faktike dhe kualifikimin ligjor të veprës penale, dhe atë pas njoftimit paraprakisht nga ana e gjykatës për favoret dhe disfavoret e pranimin të fajësisë, andaj i propozon gjykatës që ta pranojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe me rastin e shqiptimit të dënimit ta merr parasysht këtë si rrethanë lehtësuese.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Shkresat nga kallëzimi penal me nr. 2017-DHTQNJ-69; Deklarata e të pandehurit N.M. dhënë në polici e dt. 29.06.2017; Foto-dokumentacioni. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimin të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihen në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës nga neni 250 par.1 të KPRK-së, e për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysht vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPRK-ës. Si rrethana rënduese nuk ka gjetur. Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehur keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, gatishmërinë e të pandehurit për tu përgjigjur për veprën, e sidomos rrethanat personale të kryerësit, duke e vlerësuar si mbajtës i familjes, i pa punë, e sidomos duke e pasur parasysht gjendjen e vështirë ekonomike dhe materiale në të cilën jeton.

Në kuptim të nenit 75 e lidhur me nenin 74 të KPRK-së, Gjykata ka shqiptuar dënim më të ultë se minimumi i paraparë për këtë vepër, duke pasur parasysht faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale si dhe duke i pasur parasysht rrethanat dhe kushtet në të cilat jeton i pandehuri.

Andaj, Gjykata vlerëson se, dënimit me burg me kusht ndaj të akuzuarit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par. 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Poashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga veprimet e ndaluara në komunikacion, respektivisht të shtojë kujdesin gjatë pjesëmarrjes aktive në komunikacion.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne diapozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.470/2017, dt.26.04.2019

Procesmbajtësja:
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjyaktës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.